



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:126497
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05706009

CAP.nr.1413/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores së përmbarimit Sh.M nga P,,, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.S.K nga P,,, kundër debitorit të përmbarimit Drejtoria Komunale e Arsim në Prishtinë, në procedurën përmbarimore sipas dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.59/21, të datës 27.09.2022, me datën **16.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditores së përmbarimit Sh.M, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, Cpc.nr.59/21, i datës 27.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.59/21, të datës 27.09.2022, e ka refuzuar të pa pabazuar propozimi për përmbarim të kreditorit SH.M, i paraqitur me datë 12.03.2021, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsim në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori SH.M, për shkak të *shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, kostatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet Aktvendimi Cpc.Nr.59/21 i datës 27.09.2022, të lihet në fuqi propozimi dhe detyrohet Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit në

Prishtinë që në emër të shpërblimit jubilar dhe shujtave të ia paguaj kreditorit shumën si në propozim për përbarim dhe të gjitha shpenzimet procedurale.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa kreditorit të përbarimit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja e përbarimit SH.M, me datën 12.03.2021, ka paraqitur propozim për përbarim, kundër debitorit të përbarimit Drejtoria Komunale e Arsim në Prishtinë, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin Cpc.nr.59/2021 të datës 27.09.2022, e ka refuzuar propozimin për përbarim të kreditorit të paraqitur me datë 12.03.2021.

Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar drejtë, e të cilat shkaqe ankimore Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e përkrah qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e cila me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përbarimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përbarim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përbarimor është i papërshtatshëm për përbarim edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “*Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”. Në bazë të nenit të sipërcituar rrjedh se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përbarimor-vendimi administrativ i Inspektoratit të Punës 01 Nr.08-810/2020, të datës 11.08.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, për çka nuk kuptohet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me papërshtatshmërinë e përbarueshmërisë së dokumentit përbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale. Prandaj për bindjen e Gjykatës së Apelit, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar propozimin për përbarim.

Gjykata e Apelit vlerëson se pala kreditore eventualisht mund të parashtrojë propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përmbartimor, pasi që në këtë procedurë ka bërë lëshime të cilat e kanë pamundësuar përmbartimin e propozuar.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1413/23, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Arsim Hamzaj